



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2021:223172
Datë: 22.05.2024
Numri i dokumentit: 05722497

K.Dh.Shk.II.nr.527/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së dytë, me gjyqtarin individual Ramush Bardiqi, në çështjen përmbartimore të kreditorit “ TC ËEST GR” me seli në Gjakovë, me NRB 71180522 të cilin e përfaqëson sipas autorizimit Shoqëria e Avokatëve “ SCLR Partners” Sh.p.k me seli në Prishtinë, Soliteri Avalla P+12, kundër debitorit “ Kolegji “ Heimerer” Sh.p.k me seli në Prishtinë, Lagja Kalabria me NRB 70653923 të cilin e përfaqëson sipas autorizimit Avokatura “Ramaj & Palushi” L.L.C me seli në rrugën Amil Hoxha hyrja 13 nr. 5, Prishtinë lidhur me çështjen përmbartimore pagesën e borxhit, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.438/22 të datës 01.12.2023, me datën 22.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e debitorit “ Kolegji “ Heimerer” Sh.p.k me seli në Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.438/22 të datës 01.12.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.438/22 të datës 01.12.2023, e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesa për kthim në gjendje të mëparshme e debitorit Kolegji “ Heimerer” Sh.p.k për shkak të humbjes së afatit për pagesën e garancionit sipas aktvendimit PPP.nr.1495/19 të datës 11.05.2020.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor debitori ka parashtruar ankesë, me propozimin që të aprovohet ankesa e parashtruar nga debitori si e bazuar, të ndryshohet aktvendimi KPPP.nr.438/22, ashtu që të aprovohet kërkesa e debitorit për mkthim në gjendjen të mëparshme si e bazuar dhe të lejohet debitorit pagesa e garancionit si kusht për parashtrimin e ankesës ndaj aktvendimit për refuzimin e prapësimit.

Përgjigje në ankesë, ka paraqitur kreditori, me propozimin që gjykata ta refuzojë në tërësi si të pabazuar ankesën e debitorit, i parashtruar kundër aktvendimit KPPP.nr.438/22 të datës 01.12.2023.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3 par.2 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore (LPP), si dhe në kuptim të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), gjeti se:

Ankesa e debitorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori “ TC ĒEST GR” me seli në Gjakovë ka paraqitur propozim për përmbartim ndaj debitorit “ Kolegji “ Heimerer” Sh.p.k me seli në Prishtinë, Lagja Kalabria me NRB 70653923, në bazë të dokumentit të besueshëm faturave në vlerën prej 15,000.00€, me kamatë ligjore prej 8%, si dhe shpenzimet e procedurës, të gjitha në afat prej 7 ditësh.

Përmbartuesi Privat Fadil I. Hoxha me seli në Prishtinë, me urdhrin përmbartimor P.nr.176/2019 e datës 24.05.2019, e ka lejuar përmbartimin ndaj debitorit në bazë të dokumentit të besueshëm faturave, për shumën e përgjithshme prej 15,000.00€.

Debitori me datë 15.06.2022, ka paraqitur kërkesë për lirim nga garancioni i urdhëruar sipas Aktvendimit të Gjykatës Themelore Prishtinë PPP.nr.1495/2019 të datës 11.05.2020, kjo gjykatë me konkluzionin KPPP.nr.438/22 të datës 17.05.2023, e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për lirim nga garancioni.

Debitori me datë 07.06.2023, ka paraqitur kërkesë për kthim në gjendjen e mëparshme, me arsyetimin se me datë 23.05.2023, e ka pranuar konkluzionin KPPP.nr.438/22, në po të njëjtën datë i ka përcjellë përmes emailit një zyrtari në zyrën e debitorit me të cilin kishin komunikuar zakonisht, e për të cilin nuk e kanë ditur se nuk ishte më i punësuar te debitori. Pas dorëzimit të konkluzionit nuk kanë kontaktuar më tutje askënd për të konfirmuar nëse kanë pranuar të njëjtin dhe kanë bërë pagesën e garancionit që është caktuar, e pas komunikimit me debitorin rezulton se ky i fundit nuk është informuar asnjëherë për arritjen e këtij konkluzioni. E këtu propozuesit nën rrethana objektive dhe të justifikueshme iu ka pamundësuar që të bëjë pagesën brenda afatit 7 ditor. I ka propozuar gjykatës që ta aprovojë kërkesën për kthim në gjendje të mëparshme dhe të lejohet pagesa e garancionit lidhur me procedurën përmbartimore PPP.nr.1495/2019.

Gjykata Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.438/22 të datës 01.12.2023, e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesa për kthim në gjendje të mëparshme e debitorit Kolegji “ Heimerer” Sh.p.k për shkak të humbjes së afatit për pagesën e garancionit sipas aktvendimit PPP.nr.1495/19 të datës 11.05.2020, duke vendosur me decidivisht si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se pas shqyrtimit të shkresave të lëndës kërkesa e debitorit për kthimin në gjendje të mëparshme për shkak të humbjes së afatit për pagesën e garancionit është e pabazuar për shkak duke pasur parasysh neni 130 par.2 të LPK-së , me të cilin është përcaktuar *“Propozimi duhet të paraqitet brenda afatit shtatë (7) ditor nga dita kur ka pushuar shkaku i mosveprimit, e po që se pala më vonë ka mësuar për mosveprimin, atëherë afati llogaritet nga dita kur ka mësuar për mosveprimin”*, vlerësoi se në rastin konkret i autorizuari i debitorit me datën 06.06.2023, është njoftuar për mosveprim sipas aktvendimit se nuk e ka përmbushur detyrimin për pagesën e garancionit, ndërsa kërkesën për kthim në gjendje të mëparshme e ka paraqitur brenda afatit ligjor me datën 07.06.2023, andaj gjykata ka vendosur si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi duke refuzuar kërkesën për kthim në gjendjen të më parshme si të pa bazuar. Prandaj, mbi këtë bazë ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi të atakuar.

Gjykata Komerciale – dhomat e shkallës së dytë vlerëson se aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të procedurës kontestimore të parashikuara me nenin 182 par 2 të LPK, për arsye se i njëjti është i kuptueshëm, i qartë dhe se përmban arsye të mjaftuara bindëse faktike dhe juridike mbi faktet vendimtare kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, e të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Për shkak të zbatimit të rregullt të dispozitave të procedurës përmbartimore dhe për shkak të hetimit të rregullt dhe të plotë të gjendjes faktike e cila nuk vihet në dyshim me asnjë pretendim ankimor, gjykata përmbartimore drejtë e ka aplikuar edhe të drejtën materiale aplikimin e drejtë të së cilës gjykata e shkallës së dytë e heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata Komerciale – dhomat e shkallës së dytë vlerëson se gjykata e shkallës së dytë drejte ka vepruar kur e ka refuzuar si të pabazuar kërkesën mbi kthimin në gjendjen e mëparshme të parashtruar nga ana e debitorit për shkak të humbjes së afatit për pagesën e garancionit sipas aktvendimit PPP.nr.1495/19 të datës 11.05.2020 për shkak të borxhit në shumën prej 15,000.00€, për arsye se duke u bazuar në dispozitat e nenit 130 par.2 të LPK-së, me të cilën është përcaktuar se *“Propozimi duhet të paraqitet brenda afatit shtatë (7) ditor nga dita kur ka pushuar shkaku i mosveprimit, e po që se pala më vonë ka mësuar për mosveprimin, atëherë afati llogaritet nga dita kur ka mësuar për mosveprimin”*. Në rastin konkret i autorizuari i debitorit me datën 06.06.2023, është njoftuar për mosveprim sipas aktvendimit se nuk e ka përmbushur detyrimin për pagesën e garancionit, ndërsa kërkesën për kthim në gjendje të mëparshme e ka paraqitur brenda afatit ligjor me datën 07.06.2023.

Po ashtu me dispozitën e nenit 129 par.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), parashihet se *“në qoftë se pala nuk shkon në seancë fare apo e humb afatin për kryerjen e ndonjë veprimi procedural dhe për këtë shkak e humb të drejtën që më vonë të kryej veprimin procedural të*

lidhur me afat, gjykata do t'i lejojë kësaj pale, me propozimin e saj të kryej me vonë këtë veprim, po që se konstaton se ekzistojnë shkaqe të arsyeshme të cilat nuk kanë mundur të parashikohen e as të evitohen". Prandaj, nga shkresat e lëndës rezulton se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me ndonjë arsye së si rezultat i të cilit i është pamundësuar debitorit që ta paguaj garancionin sipas aktvendimit të Gjykatës Themelore Prishtinë PPP.nr.1495/2019 të datës 11.05.2020, dhe konkluzionit KPPP.nr.438/22 të datës 17.05.2023, me të cilin i është refuzuar si e pabazuar kërkesa për lirim nga garancioni, të cilin e ka pranuar i autorizuari i debitorit me datë 23.05.2023, ashtu që pretendimet e debitorit se propozuesi nën rrethana objektive dhe të justifikueshme iu ka pamundësuar që të bëjë pagesën brenda afatit 7 ditor.

Andaj, rastin konkret i autorizuari i debitorit ka pranuar në mënyrë të rregullt konkluzionin siç vërtetohet nga fletë kthesa për dorëzim personal me datë 23.05.2023, dhe se debitori nuk ka paraqitur ndonjë provë me të cilën do të vërtetonte se ka pasur ndonjë shkak të arsyeshëm që nuk do të mund të parashikohej, andaj gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi, duke e refuzuar kërkesën për kthim në gjendje të mëparshme si të pa bazuar. Prandaj, mbi këtë baze Kjo gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës e parë drejt ka vendosur kur e ka refuzuar si të pabazuar kërkesën për kthim në gjendje të mëparshme të debitorit për shkak të humbjes së afatit për pagesën e garancionit.

Gjykata Komerciale – dhomat e shkallës së dytë i ka shqyrtuar të gjitha pretendimet tjera ankimore, mirëpo të të njëjtat kanë rezultuar si të pathemelta. dhe rrjedhimisht ankesa e debitorit rezulton të jetë e pathemeltë të cilën gjykata ankimore vendosi ta refuzojë, ndërsa aktvendimin e atakuar ta vërtetojë.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 208 dhe 209 pika b) të LPK-së, e në lidhje me nenin 17 të LPP-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS,
Dhoma e shkallës së dytë
K.Dh.Shk.II.nr.527/24, me datën 22.05.2024

Gj y q t a r i,
Ramush Bardiqi